

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Rafet Haxhaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Sh.I., nga fshati ..., Komuna e Pejës, tani me vendbanim të përkohshëm në Rozhajë, Rr. "...", nr.2, R. e Malit të Zi, kundër të paditurave Qeveria e Kosovës me seli në Prishtinë, Komuna e Pejës, UNMIK-u dhe KFOR-i, në çështjen për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 240.000 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.2124/04 të datës 07.09.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2016**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pa themeltë** ankesa e paditësit Sh.I., nga fshati ..., Komuna e Pejës, tani me vendbanim të përkohshëm në Rozhajë, Rr. "...", nr.2, R. e Malit të Zi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.2124/04 i datës 07.09.2012, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2124/04 të datës 07.09.2012, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Sh.I., nga fshati ..., Komuna e Pejës, tani me vendbanim të përkohshëm në Rozhajë, Rr. "...", nr.2, R. e Malit të Zi, kundër të paditurave Qeveria e Kosovës me seli në Prishtinë dhe Komuna e Pejës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat, që në mënyrë solidare paditësit ti kompensojnë dëmin material në shumën e tërësishme prej 240.000 euro, me kamatë ligjore nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, dhe atë në emër të kompensimit të dëmit të objekteve ndërtimore në shumën prej 150.000 euro, në emër të shpenzimeve për kthim në gjendje të mëparshme të tokës-trenit në shumë prej 10.000 euro, në emër të kompensimit të dëmit material për shkatërrimin e sendeve të luajtshme në shumë prej 60.000 euro, në emër të fitimit të humbur shumën prej 10.000 euro, në emër të shpenzimeve për zhvendosje-akomodim shumën prej 10.000 euro, si dhe të detyrohen të paditurit që paditësit ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën dy hedhet si e palejuar padia e paditësit Sh.I., nga fshati ..., Komuna e Pejës, tani me vendbanim të përkohshëm në Rozhajë, Rr. "...", nr.2, R. e Malit të Zi, kundër të paditurave UNMIK-u dhe KFOR-i, për kompensimin e dëmit, ndërsa në piken tre secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe nuk ka zbatuar ligjin ashtu si duhet, me propozim që ti obligoj organet kompetente që me bëjnë kompensimin e dëmit në shumë prej

240.000 euro, dhe atë më kamatë sipas dispozitave tonë ligjore bankare për mjetet e deponuara. Të mi paguajnë shpenzimet procedurale, të gjitha këto të me bëhen në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përbarimit me dhunë pas plotëfuqishmerisë së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

#### **-Ankesa është e pa themeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurave me kërkesë për kompensim dëmi. Gjykata e shkallës së parë pas përgjigjeve në padi nga të paditurat duke u mbështetur në dispozitat e neneve 4.2, 17, 18, 73, 76, 387, 391.1 pika a), 399.1 dhe 2 të LPK-së, Rezolutës 1244, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës, neni 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45, mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, neni 2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2000/47, për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personeli i tyre, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenet 452 dhe 463.1, të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Këtë vlerësim Gjykata e Apelit e mori për arsye se në bazë të nenit 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1/1999- të datës 10 Qershor 1999, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë e cila ka hy në fuqi me 10.06.1999, shprehimisht është përcaktuar se pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën ishte përgjegjësi e UNMIK-ut dhe KFOR-it, e pas kësaj në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, janë themeluar institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, Komuna si njësi themelore dhe vetëqeverisjes lokale dhe në bazë të nenit 3 të kësaj rregullore e ushtron pushtetin e vet dhe ka statusin juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, autorizimin për të ushtruar padi dhe për të qenë palë e paditur e po ashtu janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e komunës në bazë të kësaj rregullore, po ashtu në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 të datës 13 Shtator 2001, e cila ka hy në fuqi me 13 Shtator 2001, ka paraparë shprehimisht në nenin 7, se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nuk mund zvogëloj autoritetin suprem të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në zbatimin e rezolutës 1244/1999, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe se e ka autoritetin definitiv për interpretimin e fushë veprimit dhe parametrave të tjerë të përgjegjësive ekzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të përcaktuara në bazë të kësaj rregullore e që dega e ekzekutivit, përkatësisht në bazë të nenit 1, të kësaj rregullore, janë themeluar institucionet e përkohshme të qeverisjes që përbëhet nga qeveria.

Nga të cekurat më lart rrjedh se e paditura e parë Qeveria e Kosovës dhe e paditura e dytë Komuna e Pejës nuk kanë pasur autorizime dhe përgjegjësi për veprimet e dëmshme të shkaktuara në pasurinë e paditësit, për faktin se në bazë të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 të dt.10.06.1999, Qeveria dhe Komuna nuk kanë pasur autorizime lidhur me sigurimin e rendit dhe të qetësisë në kohën kur është shkaktuar dëmi i pretenduar nga ana e paditësit dhe për këto arsye Qeverisë së Kosovës dhe Komunës së paditur u mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje sikurse me të drejtë gjykata e shkallës së parë ndaj tyre ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar, për faktin se nuk janë pjesëmarrës të raportit juridik nga i cili për të paditurat rrjedhin detyrime dhe se çështjen se a mundet me qenë palë në procedurë, gjykata e vlerëson dhe kujdeset gjithmonë në bazë të detyrës zyrtare gjatë tërë procedurës e në bazë të nenit 76 të LPK-së.

Po ashtu me të drejtë është hedhur poshtë kërkesëpadia ndaj të paditurave UNMIK-ut dhe KFOR-it, për arsye se, në bazë të nenit 2. pika 2.4, a) dhe nenit 3. pika 3.2. të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/47 të datës 18 Gusht 2000, shprehimisht është përcaktuar KFOR-i dhe UNMIK-u dhe personeli i tyre janë të liruar nga juridiksioni vendor përkatësisht para gjykatave në Kosovë, në lidhje me çfarëdo veprimi administrativ, civil apo kriminal të kryer nga ta në territorin e Kosovës.

Gjykata i ka vlerësuar pretendimet ankimore të palës paditëse, por ka vlerësuar se nga arsyet e theksuara me lartë janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195 pika d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.541/2013, më datë 23.05.2016**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
*Fejzullah Rexhepi*